



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË GJIROKASTËR

P/V E N D I M

Nr. ____ Datë. ____/____/2024

**PËR SHPREHJEN E PËLQIMIT PËR REALIZIMIN E SHPRONËSIMEVE NË ZONËN
E PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I AMBJENTEVE TË TREGUT TË PRODUKTEVE
BUJQËSORE DHE BLEGTORALE SI DHE RRUGËN E AKSESIT”**

Në mbështetje të nenit 8 “ Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” dhe të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , VKM-së Nr.138, datë 23/03/2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvillohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, shkresës Nr.4705/1 Prot, datë 22.10.2024 të ASHK Drejtoria Vendore Gjirokastrë dhe relacionit të Drejtorisë së Urbanistikës Nr. Prot, datë .06.2025 , pasuritë që do të shpronësohen për efekt të kryerjes së investimit janë si më poshtë:
Në mbledhjen e datës _____.____.2025, Këshilli i Bashkisë ,

V E N D O S I:

Të japë pëlqimin për shpronësimin për pasuritë si më poshtë, sipas sipërfaqeve dhe vlerave takuese;

Nr.	Nr. pasurisë	Zona kadastrale	Lloji i pasurisë	Pronari	Sipërfaqja takuese në m ²	Vlera në lekë
1	28/187	8541	GODINË Objekt 1+2 Kat Ligji për ALUIZNI	Katerina Bush Maria Molla Olimbi Bushi	126.4	1 834 549 + 614 936 TRUALLI= 2 449 485 (sipas vkm nr.138, datë 23.08.2000, i ndryshuar)

2	28/137	8541	TRUALL	Aleksandra Lluci Fotaq Qifti Ilia Qifti Uberta Luzi Vangjel Qifti	236	1 148 140
3	28/139	8541	TRUALL	Anastas Taçi Arjan Guna Besnik Fuqi Katerina Telo Spiro Fuqi Tumen Kazo Vasil Taçi	50	243 250
4	28/224	8541	TRUALL	Stefan Simo	19	92435

VLERA TOTALE=3 933 309 LEKË

Bashkangjitur plan vendosja me njollën e projektit, kartelat e pasurisë dhe fragmenti i hartës kadastrale të ardhura nga ASHK, Drejtoria Vendore Gjirokastër me shkresën Nr.1844/1 Prot.,datë 27.05.2025.

Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës ,plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme ngarkohet Kryetari i Komisionit të Shpronësimit Z.Nertil Nebiaj dhe Drejtoria e Financës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

NR _____, DATË _____

“PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK 2024”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____ pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për Miratimin e Buxhetit Faktik 2024”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. Datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të etëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, VKB nr 113 datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” i ndryshuar.

V E N D O S I

1. Të miratojë buxhetin faktik 2024 në Bashkinë Gjirokastrë sipas dokumentit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo